



Republika e Kosovës - Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2022

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP
Prishtinë, Mars 2023

Rruga Luan Haradinaj "Ndërtesa e ish Bankës së Lubjanës kati –I-, 10000 Prishtinë

info@pzap-ks.org, www.pzap-ks.org 038/211-242

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA.....	3
Lista e shkurtesave.....	4
Përmbledhje ekzekutive.....	5
Vizioni dhe misioni.....	8
Vizioni.....	8
Misioni.....	8
Korniza ligjore	8
Struktura Organizative e PZAP-it	9
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa/PZAP përbehet.....	10
Struktura organizative Sekretariatit të PZAP-it.....	12
Zyra e Kryesuesit të Sekretariatit të PZAP-it.....	12
Departamenti Ligjor	12
Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme	13
Organogrami i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa – (PZAP)	13
Zhvillimi i aktiviteteve të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa	14
Ankesat/Apelet e pranuar në PZAP.....	16
Përfaqësimi institucional i PZAP-it.....	17
Takimet e PZAP-it, me delegacionin e anëtarëve të Misionit të BE-së.....	17
Takimi i PZAP-it, me Rrjetin Rajonal të Drejtësisë Zgjedhore për Evropë dhe Euro Azi	18
Takim me Rrjetin Gjyqësor Zgjedhor nën rajonal	18
Takimet me anëtarët e Komisionit Ad hoc, për reformën zgjedhore.....	19
Aktivitetet e Sekretariatit.....	20
Përgatitjet për zgjedhjet e jashtëzakonshme	23
Bashkëpunimi me akteret e tjerë të zgjedhjeve	23
Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe ngritja e kapaciteteve.....	24
Trajnimet e zyrtareve të sekretariatit.....	25
Aktivitetet nga fusha e prokurimit.....	26
Aktivitetet lidhur me shpenzimet financiare të certifikuara	26
Aktivitetet nga fusha e komunikimit dhe informimit	27
Kërkesat për Qasje në dokumente publike.....	28
Buxheti dhe financat.....	28
Auditimi i pasqyrave financiare të PZAP për vitin 2021.....	37
Njësia e Teknologjisë së Informacionit dhe Logjistikes.....	37
Njësia e Përkthimeve	38
Njësia e Transportit.....	38

Lista e shkurtesave

PZAP – Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

SPZAP – Sekretariati i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

KQZ – Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

KGJK – Këshilli Gjyqësor i Kosovës

KPK – Këshilli Prokurorial i Kosovës

PK – Policia e Kosovës

MF - Ministria e Financave

MPB – Ministria e Punëve të Brendshme – Administrata Publike

OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian

LZP – Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme

LZL – Ligji për Zgjedhjet Lokale

ZYRA - Zyra për Regjistrimin, Certifikim dhe Kontroll Financiar të Subjekteve Politike

SP- Subjektet Politike

KP – Kandidat i Pavarur

QNR – Qendra për Numërimin e Rezultateve

SIMFK – Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës

SIMBNJ/HRMIS – Sistemi Informativ i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

SMVP – Sistemi i Menaxhimit të Vijueshmërisë në Punë

SIMR – Sistemi Informativ i Menaxhimit të Rasteve

NJQH - Njësia Qendrore Harmonizuese

ZKA - Zyra Kombëtare e Auditimi

AQP - Agjencia Qendrore e Prokurimit

KRRPP – Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik

DMZP – Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik

Përmbledhje ekzekutive

Raporti vjetor i punës së Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa /PZAP, për vitin 2022 pasqyron aktivitetet e realizuara në përmbushje të kërkesave të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Ky raport është dëshmi e punës së PZAP-it, i realizuar me përkushtim dhe profesionalizëm nga ana e anëtarëve të PZAP-it, dhe stafit të administratës së Sekretariatit, siç janë puna e panelit në vendosjen e ankesave/apelve të paraqitura nga subjektet politike, rezultatet e arritura të departamenteve dhe të njësive tjera të administratës së sekretariatit, aktivitetet e prokurimit, aktivitetet lidhur me çështjet e personelit, shpenzimet buxhetore, komunikimi dhe bashkëpunimi me akterët zgjedhor, të dhëna për pjesëmarrjen e anëtarëve të PZAP-it dhe stafit të sekretariatit në konferencat dhe në punëtoritë e organizuara.

PZAP, gjatë kësaj periudhe raportuese ka realizuar objektivat dhe aktivitetet e përcaktuara me Planin e Punës për vitin 2022, dhe jo vetëm, por ka kryer edhe aktivitete të cilat nuk kanë qenë të planifikuara me planin e punës, siç ishin aktivitetet lidhur me Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për kryetar në Komunitet: Mitrovica e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan, të cilat zgjedhje me vendimin nr. 76/2022, të datës 14.11.2022, të Presidentes së Republikës së Kosovës, janë caktuar dhe shpallur për tu mbajtur më datë 18.12.2022, pas dorëheqjeve të kryetarëve të këtyre katër komunave respektive si dhe Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendet Komunale Zveçan dhe Leposaviq, të cilat zgjedhje me vendimin nr. 77/2022, të datës 25.11.2022, të Presidentes së Republikës së Kosovës, janë caktuar dhe shpallur për tu mbajtur më datë 25.12.2022, Pas shpërbërjes së Kuvendeve të këtyre dy Komunave.

PZAP-i, në zbatim të mandatit të tij të përcaktuar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) si dhe duke zbatuar praktikën nga zgjedhjet e kaluara, edhe për këto zgjedhje përkundër se nuk ishte vit i rregullt zgjedhor ka bërë përgatitjet e nevojshme dhe ka hartuar planin e veprimit për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për kryetar në Komunitet: Mitrovica e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan, dhe për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendet e Komunave Zveçan dhe Leposaviq, mirëpo përkundër përgatitjes së plani të veprimit dhe kryerjes së disa aktiviteteve për zgjedhjet e theksuara më lartë për arsye objektive ato nuk janë mbajtur, respektivisht me vendimin Nr.79/2022 të datës 10.12.2022 të Presidentes së Republikës së Kosovës janë shtyrë dhe është caktuar data e re e mbajtjes së tyre më 23.04.2023. PZAP-i, gjithashtu deri në marrjen vendimit nga Presidentja e Republikës së Kosovës për shtyrjen e zgjedhjeve, ka kryer edhe disa aktivitete tjera të ndërlidhura me këto dy procese zgjedhore siç janë njoftimi i KQZ-së, në lidhje me gjobat e papaguara të subjekteve politike, dhe për personat të cilëve me vendimet e PZAP-

it, ju është ndaluar e drejta për pjesëmarrja në zgjedhje si kandidat apo si anëtar të Trupave Menaxhuese të Zgjedhjeve të organizuara nga KQZ-ja.

Për qëllim të unifikimit të katër rregulloreve, dhe nevojës së përgatitjes të një rregulloreje të vetme për zbatim sa më të lehtë për vetë institucionin dhe palët tjera me interes ligjor, PZAP, në nëntor të vitit 2022 ka miratuar Rregulloren NR. 01/2022, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave dhe Apeleve, falë kontributit të grupit punues të cilët punuan në përbërje të Panelit dhe të Sekretariatit.

Gjithashtu brenda vitit 2022, është punuar dhe finalizuar vëllimi i tretë i Buletinit të PZAP-it, përmes së cilit janë paraqitur pesëdhjetë vendime më të rëndësishme që PZAP-i, ka nxjerr për tri palë zgjedhje të organizuara në Kosovë në vitin 2019 dhe në vitin 2021, që kanë të bëjnë me ankesat e palëve të interesuar nga pretendimet e tyre se janë shkelur të drejtat gjatë procesit zgjedhor, në fazën e para fushatës zgjedhore, fushatën zgjedhore, thyerjen e heshtjes zgjedhore, ditën e zgjedhjeve, administrimin e rezultateve në qendrën e numërimit dhe rezultateve (QNR).

Përmes platformës elektronike në Sistemin Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (SIMBNJ), është vazhduar me menaxhimin e burimeve njerëzore, është përgatit plani i punës, është bërë përditësimi i të dhënave të nëpunësve civil dhe anëtarëve të PZAP-it, në dosjet e tyre personale në mënyrë fizike dhe elektronike, si dhe është përgatitur raporti vjetor i resurseve njerëzore të PZAP-it, për vitin 2022.

Për zbatim të Rregullores Nr.01/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në PZAP, njësia e Burimeve Njerëzore ashtu siç kishte planifikuar në vitin 2022, ka bërë zhvillimin e procedurës së rekrutimit përmes lëvizjes brenda kategorisë për pozitën Drejtor i Departamentit Ligjor. Kjo procedurë ka rezultuar të jetë e suksesshme dhe me plotësimin e kësaj pozite bëhet edhe kompletimi i Sekretariatit të PZAP-it me stafin e rregullt. Njësia e personelit në bashkëpunim me IKAP-in, DMZP/MPB dhe Bashkimin Evropian, ka organizuar rreth 20 trajnime me tema të ndryshme në të cilat kanë marrë pjesë stafi i sekretariatit të PZAP-it.

Janë realizuar disa takime në mes të PZAP-it, dhe delegacionit të anëtareve të Misionit të BE-së, lidhur me zbatimin e rekomandimeve të këtij Misioni për reformën zgjedhore sipas kërkesës së Zyrës së Përfaqësuesit Special të BE-së (EUSR), pastaj pjesëmarrja e kryesuesit të SPZAP-it në takimin e organizuar nga Zyra Rajonale e Evropës IFES, në bashkëpunim me Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Gjykatës Administrative të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me qëllim të shkëmbimit të përvojave të drejtësisë zgjedhore rajonale, praktikave të mira, si dhe identifikimit të sfidave të përbashkëta gjatë proceseve zgjedhore, të mbajtur në Shkup.

Në vazhden e këtyre takimeve, kryesuesi i PZAP-it, me kryesuesin e SPZAP-it, ka marrë pjesë edhe në takimin e Rrjetit Gjyqësor Zgjedhor të organizuar nga Zyra Rajonale e IFES-it në Evropë, në bashkëpunim me përfaqësuesit e Komisionit Shtetërorë të Zgjedhjeve (KSHZ) dhe Kolegjit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, ku pjesëmarrës kanë qenë ekspert dhe zyrtar përgjegjës nga rajoni i Ballkanit Perëndimor, përfshirë Shqipërinë, Kroacinë, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Serbia.

Gjatë vitit 2022, vlera e shpenzimeve ka arritur në 181,932€ apo 85% e buxhetit të aprovuar të PZAP-it është shpenzuar, kështu që në kategorinë e pagave dhe mëditjeve janë shpenzuar 97% e buxhetit, në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve 61%, në kategorinë e shërbimeve komunale 1%, dhe në kategorinë e shpenzimeve kapitale buxheti është shpenzuar 99%.

Në vitin 2022 në llogarinë e PZAP-it, janë realizuar të hyra buxhetore në shumë prej 39,400 €, fond ky i mbledhur nga gjobat e subjekteve politike dhe të njëjtat janë alokuar në Buxhetin e shtetit.

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), në Raportin e auditimit të PZAP-it për vitin financiar 2021 të datë 17.06.2022, ka konstatuar se Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin 2021 prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa/PZAP, është organ i përhershëm dhe i pavarur, kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat dhe apelet e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor siç është përcaktuar me LQP dhe Rregullat Zgjedhore Ligji Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovë (Neni 115)

Vizioni dhe misioni

Vizioni

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa PZAP, është dhe synon të jetë një institucion i besueshëm, i qëndrueshëm, i fuqizuar dhe inovativ, që punon për forcimin e drejtësisë zgjedhore.

Misioni

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa PZAP, me qëllim të fuqizimit të demokracisë, është i përkushtuar që me profesionalizëm, paanshmëri dhe me kohë të zgjidhë kontestet zgjedhore për të siguruar të drejtat për të gjithë akterët lidhur me procesin zgjedhor.

PZAP, është i përkushtuar për përmbushjen me besnikëri të detyrave në përputhshmëri me kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës. Të gjitha vendimet i merr në baza etike duke u bazuar në të gjitha provat për të promovuar besimin publik në aktivitetet e tij në përputhshmëri me ligjin, të pa ndikuara nga jashtë. Është i hapur dhe është përgjegjës për veprimtarinë që zhvillon si dhe siguron qasje për marrjen e informatave për të gjitha palët e interesuara.

Korniza ligjore

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa/PZAP, gjatë realizimit të mandatit dhe ushtrimit të kompetencave, bazohet në kornizën ligjore primare dhe sekondare, për të siguruar të drejtat e të gjithë qytetarëve me të drejtë vote, subjekteve politike, dhe akterëve tjerë të cilët kanë të drejtë të ankohen lidhur me kontestet zgjedhore. Vendimet e PZAP-it, janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga KQZ-ja, përveç në rast se apeli i lejuar parashtrohet brenda kohës së paraparë dhe Gjykata Supreme e Kosovës e përcakton ndryshe, e cila Gjykatë është instanca e fundit e zgjidhjes së kontesteve zgjedhore.

Korniza ligjore primare bazike, por që nuk kufizohet vetëm, ngase PZAP realizon mandatin e tij edhe përmes legjislacionit si në vijim:

- Ligji Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës;
- Ligji Nr.03/L-256 për ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës;
- Ligji Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës;

- Rregullat Zgjedhore të KQZ-së.
- Me qëllim të zbatimit sa më të lehtë të legjislacionit primar dhe krijimit të strukturave tjera organizative, siç është sekretariati i PZAP-it, PZAP ka nxjerr dokumentet e nevojshme nënligjore dhe dokumentet tjera strategjike, si:
- Rregulloren Nr. 01/2022 Për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave dhe Apeleve;
- Rregulloren Nr.01/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në PZAP;
- Rregulloren Nr.02/2019 për Përshkrimin e Detyrave dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në PZAP.

Struktura Organizative e PZAP-it

Sipas Ligjit Nr. 03/L-L073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Ligjin Nr. 03/L-256, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-L073, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), përbehet prej (gjyqtareve të gjykatave të rregullta të Kosovës) degës së gjyqësorit dhe kategorisë së të punësuarve në nivelin administrativ të cilët janë përgjegjës në përmbushjen e mandatit ligjor.

Në kuadër të degës së gjyqësorit, PZAP përbehet nga 10 gjyqtarë të gjykatave të ndryshme në nivel vendi, të cilët emërohen nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, me mandat 4 vjeçar me mundësi edhe të një mandati tjetër. Kryesuesi emërohet nga radhët e gjykatësve të Gjykatës Supreme të Kosovës, ndërsa anëtarët emërohen nga radhët e gjykatësve të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatave Themelore të regjioneve të ndryshme të Republikës Kosovës.

Kryesuesi i PZAP-it, cakton përbërjen e paneleve, të cilët mbledhen prej së paku 3 (tre) anëtarëve, ku njëri nga ata është kryesues i panelit.

Me buxhetin e vitit 2022 të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, PZAP-i, ka të lejuara/aprovuara 20 pozita, prej tyre: 1 (një) Kryesues të PZAP-it, 9 (nëntë) anëtar të panelit të PZAP-it, 1 (një) Kryesues të Sekretariatit të PZAP-it dhe 9 (nëntë) zyrtarë të sekretariatit të PZAP-it.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa/PZAP përbehet

1. Shukri Sylejmani, Kryesues i PZAP-it/Gjyqtar i Gjykatës Supreme të Kosovës;
2. Adnan Konushevc, anëtarë i PZAP-it/Gjyqtar i Gjykatës Themelore – Prishtinë
3. Kymete Kicaj, anëtare e PZAP-it/Gjyqtare e Gjykatës Themelore-Prizren;
4. Ferki Xhaferi, anëtar i PZAP-it/Gjyqtar i Gjykatës Themelore- Vushtrri
5. Burim Ademi, anëtarë i PZAP-it/Gjyqtarë i Gjykatës së Apelit – Prishtinë
6. Franciska Zhitija-Ymeri, anëtare e PZAP-it/Gjyqtare e Gjykatës së Apelit-Prishtinë
7. Hajriz Hoti, anëtar i PZAP-it/Gjyqtar i Gjykatës së Apelit – Prishtinë;
8. Arsim Hamzaj, anëtar i PZAP-it/Gjyqtar i Gjykatës së Apelit – Prishtinë

Me rastin e përfundimit të mandatit të dytë të tre anëtarëve të PZAP-it: znj. Afijete Sada-Gllogjani, Zyhdi Haziri, dhe Faton Ademi, në kuptim të nenit 115.4 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, me vendimin numër GJ.A- S.U.A 248-2022, të datës 21 Nëntor 2022, në dy prej pozitave të zbrazëta ka emëruar z. Hajriz Hoti, Gjyqtar i Gjykatës së Apelit në Prishtinë dhe z. Arsim Hamzaj, Gjyqtar i Gjykatës së Apelit në Prishtinë, si anëtarë të ri PZAP-it, ndërsa një pozitë ka mbetur ende e zbrazët.

Për shkak të dorëheqjes së gjyqtarëve z. Rustem Thaqi dhe znj. Milena Deriq, dhe emërimit të tyre në pozitën e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Kosovës, në kuptim të nenit 115.4 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, të njëjtit janë zëvendësuar nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, me vendimin GJ.A- S.U.A 45/2022, të datës 01 Mars 2022, ka emëruar për anëtare të PZAP-it znj. Franciska Zhitija-Ymeri, Gjyqtare e Gjykatës së Apeli në Prishtinë, dhe me vendimin GJ.A- S.U.A 200/2022, të datës 07 Tetor 2022, ka emëruar për anëtar të PZAP-it z. Nikolla Petronijeviq, Gjyqtar i Gjykatës Themelore në Mitrovicë.



Shukri Sylejmani,
kryesues



Adnan Konushevci,
anëtar



Kymete Kicaj,
anëtare



Ferki Xhaferi,
anëtar



Burim Ademi,
anëtar



Franciska Zhitija-Ymeri,
anëtare



Hajriz Hoti,
anëtar



Arsim Hamzaj,
anëtar

Struktura organizative Sekretariatit të PZAP-it

Në përmbushjen e funksioneve dhe përgjegjësi ligjore që ka Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, mbështet nga udhëheqësi i Sekretariatit dhe zyrtarë të tjerë të cilit ofrojnë përkrahje profesionale dhe teknike për të gjitha çështjet administrative të ndërlidhura me funksionimin e tij të përcaktuara me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligjet tjera të aplikueshme në Kosovë.

Organizimi i brendshëm i Sekretariatit të PZAP-it, është i rregulluar me Rregulloren Nr.01/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në PZAP. Sipas kësaj Rregullore, struktura e sekretariatit përbehet prej zyrës së kryesuesit të sekretariatit dhe prej dy departamenteve :

Zyra e Kryesuesit të Sekretariatit të PZAP-it

Sekretariati ndihmon PZAP-in, në ushtrimin e përgjegjësi dhe funksioneve të tij në pajtim me LZP.

Sekretariati i PZAP-it ka një udhëheqës të zyrës, respektivisht kryesuesin e sekretariatit i cili, nën drejtimin e Kryesuesit të PZAP-it, është përgjegjës për të gjitha çështjet administrative të ndërlidhura me funksionimin e PZAP-it, Zyrën e kryesuesit të sekretariatit e përbejnë kryesuesi dhe Asistentja Ekzekutive.


Departamenti Ligjor

Ndër përgjegjësitë kryesore që ka, mbështet punën profesionale të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa dhe Sekretariatit, duke siguruar kryerjen e shërbimeve juridike, këshilluese, për të siguruar menaxhim efektiv, identifikimin e nevojave për hartimin e politikës së legjislacionit primar dhe sekondar, përgatitjen e paneleve të PZAP-it, si dhe ka për qëllim ndërmarrjen e veprimeve dhe aktiviteteve të duhura për të gjitha çështjet administrative të ndërlidhura me funksionimin e Departamentit. Në kuadër të këtij departamenti janë të punësuar katër (4) zyrtarë, përfshirë Drejtorin e departamentit ligjor dhe tre (3) zyrtar të lartë ligjor, ku secili prej tyre është pjesë e njërit nga panelet e PZAP-it.

Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme

Është përgjegjës për menaxhimin dhe përkujdesjen e burimeve materiale, ofrimin e shërbimeve administrative dhe teknike, menaxhimin e financave dhe buxhetit, Teknologjisë Informative si dhe logjistikën e PZAP-it. Në kuadër të këtij departamenti janë të punësuar katër (4) zyrtarë Drejtoresha e departamentit për Financa, Administratori i Teknologjisë Informative, Koordinator i Përkthimeve dhe Zyrtari i Transportit.

Organogrami i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - (PZAP)




Përfaqësimi gjinore dhe i komuniteteve në kuadër të PZAP

Nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të PZAP-it, përfshirë kryesuesin aktualisht është tetë (8), prej tyre gjashtë (6) janë të gjinisë mashkullore ose 75% ndërsa dy (2) janë të gjinisë femërore ose 25%, kurse sa i përket përkatësisë nacionale që të gjithë tetë (8) anëtarët janë shqiptarë ose 100%.

Përfaqësimi gjinor dhe i komuniteteve në kuadër të Sekretariatit të PZAP-it.

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në Sekretariatit e PZAP-it, është 10 zyrtarë, prej tyre gjashtë (6) janë të gjinisë mashkullore ose 60%, ndërsa 4 janë të gjinisë femërore ose 40%, kurse sa i përket përkatësisë nacionale nëntë (9) janë shqiptarë ose 90% ndërsa një (1) i punësuar është i përkatësisë boshnjake, ose 10%.



Zhvillimi i aktiviteteve të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa PZAP-i, në bazë të funksioneve dhe përgjegjësi të tij të përcaktuara me LZP, përveç vendosjes së ankesave dhe apeleve që parashtrihen gjatë procesit zgjedhor, kryen edhe aktivitetet tjera të ndryshme që nuk ndërlidhën me funksionimin e rregullt të institucionit.

PZAP-i, gjatë vitit 2022 ka mbajtur takime/mbledhje të rregullta në të cilat takime janë shqyrtuar, diskutuar dhe janë nxjerr vendime në përputhje me LZP-në, si dhe ligjet tjera të aplikueshme. Janë marrë vendime administrative për çështje të ndryshme që janë në

mandatin e institucionit, në kuptim të menaxhimit të gjithmbarshëm të punës së PZAP dhe Sekretariatit.

Vendimet kryesore të marra nga PZAP-i

- Vendimi për miratimin e Planit të Punës së PZAP-it, për vitin 2022,
- Vendimi për miratimin e Raportit të Punës së PZAP-it, për vitin 2021,
- Vendimin për aprovimin e pjesëmarrjes së Kryesuesit të sekretariatit të PZAP-it, në takimin e tretë të Rrjetit të Jurisprudencës Rajonale të Evropës dhe Euro Azisë, në Shkup të Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- Vendimi për Formimin e Grupit Punues Për Hartimin (Unifikimin) e Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it,
- Vendimi për Planin e Veprimit për Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për kryetar të Komunave: Mitrovica e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan të cilat do të duhej të mbaheshin më datë 18 Dhjetor 2022,
- Vendimi për Planin e Veprimit për Zgjedhjet e Parakohshme për kuvend të Komunave Leposaviq dhe Zveçan,
- Vendimi për zgjatjen e orarit të punës për personelin e Sekretariatit të PZAP-it (SPZAP) gjatë Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme të 18 Dhjetor 2022, dhe për Zgjedhjet e Parakohshme për kuvend të Komunave Leposaviq dhe Zveçan,
- Vendim për pagesën e shtesave për personelin e SPZAP-it, gjatë Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave të Veriut, të datës 18 Dhjetor 2022, dhe për Zgjedhjet e Parakohshme për kuvend të Komunave Leposaviq dhe Zveçan,
- Vendimi për miratimin e Raportit tre mujor (Janar-Mars) të PZAP-it për vitin 2022,
- Vendimi për miratimin e Raportit gjashtëmujor (Janar-Qershor) të PZAP-it për vitin 2022,
- Vendimi për Miratimin e Rregullës 01/2022, Për Procedurat e Shqyrtimit dhe Vendorsjes së Ankesave dhe Apeleve,
- Vendimin për aprovimin e pjesëmarrjes së përfaqësuesve të PZAP-it, në takimin e Rrjetit Gjyqësor Zgjedhor të organizuar nga Zyra Rajonale IFES, në Tiranë të Republikës së Shqipërisë,
- Vendimet për udhëtimet zyrtare për anëtarët e PZAP-it, dhe zyrtarët e Sekretariatit të PZAP-it, për punëtorit e organizuara/mbajtura në Durrës.

Ankesat/Apelet e pranuar në PZAP

Bazuar në mandatin ligjor që PZAP-i ka, edhe në vitin që lamë pas, përkundër se nuk ishte vit zgjedhor ka pranuar ankesa dhe apele, të cilat janë shqyrtuar dhe është vendosur për to.

PZAP-i, ka pranuar apelin Anr.01/2022, paraqitur nga B.M. kandidat për Kuvendin Komunal në Kamenicë nga subjekti politik AAK, e paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr. 971/4-2022 , të datës 16 Gusht 2022. Me këtë apel parashtuesi ka/kishte kërkuar që të emërohet si anëtar i kuvendit Komunal në Kamenicë për shkak se siç ka pretenduar ai, pavarësisht gjinisë ai ka pasur më shume vota se kandidatja e cila është emëruar si anëtare e Kuvendit Komunal në Kamenicë.

PZAP-i, pasi që ka shqyrtuar dhe analizuar provat që gjendeshin në shkresat e lëndës, ka/kishte refuzuar si të pabazuar apelin në fjalë dhe kishte vlerësuar se me këtë veprim KQZ, ka vepruar drejtë me vendimin e tij pasi që subjekti politik AAK në Kamenicë, ka fituar 4 ulëse në Kuvendin Komunal e ku numri më i vogël nga të dy gjinitë duhet të jetë 2 (dy), pra duhet të jenë dy meshkuj dhe dy femra, sepse po të jetë ndryshe nuk do të arrihet përfaqësimi minimal në kuotën prej 30% i gjinisë së kundërt.

Andaj PZAP-i, ka/kishte gjetur se KQZ me të drejt ka zbatuar dispozitën ligjore të nenit 8.3, 8.4 të Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, dhe mbi këtë bazë kishte konstatuar se i njëjti nuk i kishte plotësuar kriteret e sipërcituara për tu emëruar si anëtar i Kuvendit Komunal në Kamenicë.

PZAP-i, ka pranuar apelin Nr. 01/2022 të datës 06.12.2022, paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr. 01/1577-2022 datë 05.12.2022, për shkak të mos certifikimit të 14 kandidatëve për Zgjedhjet e Parakohshme për anëtarë të Kuvendit Komunal në Leposaviq.

PZAP-i, pas administrimit të shkresave të lëndës, ka vendosur që të MIRATOHET apeli i subjektit politik LVV si i bazuar, ndërsa vendimin e ankimuar të KQZ-së, ta anuloj dhe çështjen të ja kthej në rivendosje KQZ-së, ku KQZ-ja në ri procedurë obligohet që ta rishqyrtonte rekomandimin e Zyrës edhe për 14 kandidatët të cilët nuk ishin certifikuar nga KQZ-ja, dhe pas vlerësimit dhe verifikimit nga Zyra si dhe plotësimit të kushteve ligjore nga neni 29 i LZP-së, duke respektuar edhe kuotën gjinore, të merret vendim i drejtë dhe i ligjshëm.

Vendimet e PZAP-it, janë të publikuara në ueb faqen e PZAP-it, dhe në kopje fizike iu janë dorëzuar palëve.

Përfaqësimi institucional i PZAP-it

Takimet e PZAP-it, me delegacionin e anëtarëve të Misionit të BE-së

Gjatë vitit 2022, PZAP-i, ka realizuar disa takime pune me akter vendor dhe ndërkombëtarë, pjesëmarrja në tryeza diskutimi dhe punëtori për qellim të shkëmbimit të përvojave dhe gjetjes së mundësisë së adaptimit në nivel të institucionit.

Edhe në vitin 2022 nuk ka munguar koordinimi dhe bashkëpunimi me misionin e BE-së në Kosovë. Me kërkesë të Përfaqësuesit Special të BE-së (EUSR), në shkurt të vitit 2022 është mbajtur takimi i parë, në mes të delegacionit të anëtarëve të Misionit të BE-së, dhe përfaqësuesve të PZAP-it, Kryesuesit të panelit dhe Kryesuesi i Sekretariatit. Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi lidhur me gjetjet dhe rekomandimet misionit me akterë të ndryshëm kyç në Kosovë, ndër ta edhe PZAP-i, si dhe ndarja e raportit përfundimtar të Misionit të BE-së, për Vëzhgimin e Zgjedhjeve të vitit 2021. Takimi i radhës ndërmjet përfaqësuesve të këtyre institucioneve është mbajtur në nëntor 2022, ku qëllimi i këtij takimi ishte për të parë se sa janë zbatuar rekomandimet e Misionit të BE-së, për vëzhgimin nga zgjedhjet e kaluara.

Në takimin tjetër të përfaqësuesve të PZAP-it, dhe delegacionit të Misionit përcjellës të zgjedhjeve të BE-së (EFM) në Kosovë në krye Kryesuesin e Misionit përcjellës i zgjedhjeve të BE-së, është mbajtur 17 nëntor 2022, në të cilin takim është diskutuar me krerët e institucioneve dhe liderët e partive politike në Kosovë për reformën zgjedhore.

Zyra e BE-së në Kosovë dhe PSBE-ja, në dhjetor ka organizuar një tryezë të rrumbullakët me akterët e zgjedhjeve në Kosovë për të diskutuar, çështjet që kanë të bëjnë me procesin e reformës zgjedhore.

Në takim janë trajtuar temat:

- Prezantimi i misionit përcjellës të zgjedhjeve të BE 2022 (EFM) dhe mandati i tij,
- Prezantimi i rekomandimeve prioritare të Misionit të BE-së për Vëzhgimin e Zgjedhjeve 2021 (MVZ); Fokusimi i tryezës në fushat kryesore,
- Përditësim mbi reformën legjislative nga Komisioni Ad Hoc/Kuvendi i Kosovës dhe KQZ,
- Diskutim i hapur mbi zbatimin e rekomandimeve kryesore të MVZ të BE-së,
- Rekomandim për ndryshime në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (Administrimi Zgjedhor,
- Regjistrimi i Votuesve, Votimi, Numërimi dhe Tabelimi),
- Rekomandime për financimin e fushatës,
- Rekomandime për Mjedisin Mediatik dhe Mediat Sociale.

Takimi i PZAP-it, me Rrjetin Rajonal të Drejtësisë Zgjedhore për Evropë dhe Euro Azi

PZAP-i, gjatë muajit maj 2022, ka marrë pjesë në takimin e organizuar nga Zyra Rajonale e Evropës IFES, në bashkëpunim me Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Takim i Rrjetit të Jurisprudencës Rajonale të Evropës dhe Euro Azisë është mbajtur në Shkup, të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe ka qenë vazhdimësi dhe shtytje e mëtejme në shkëmbimin e përvojave të drejtësisë zgjedhore rajonale, praktikave të mira, si dhe një mjet produktiv për të identifikuar sfidat e përbashkëta që ofrojnë mbështetje në nismat e bashkëpunimit rajonal e me gjerë.

Ky takimi i organizuar është vazhdimësi e dy takimeve të më hershme të cilat janë mbajtur njëri në Shtator 2018, në Vilnius të Lituanisë në të cilin ka marrë pjesë Kryesuesja e PZAP-it dhe takimi i dytë i mbajtur në Tetor 2019, në Sarajevë të Bosnjës dhe Hercegovinës në të cilën ka marrë pjesë një anëtar i PZAP-it.

Me autorizimin dhe aprovimin e kryesuesit të PZAP-it, në takimin e mbajtur në Shkup të Republikës së Maqedonisë së Veriut ka marrë pjesë kryesuesi i sekretariatit të PZAP-it.

Në këto takime kanë marr pjesë ekspert nga rajoni i Ballkanit Perëndimor, përfshirë Shqipërinë, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Serbia me pjesëmarrje nga Gjeorgjia si vëzhgues, ekspert nga Filipinet dhe Meksika së bashku me përfaqësues nga Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë(OSBE/ADHIR) dhe Komisioni i Venecias.

Në takim janë trajtuar temat si: Sfidat procedurale në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve zgjedhore, pavarësia dhe paanësia në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve zgjedhore, përdorimi i teknologjisë informative në zgjedhje (TI), mediat sociale dhe përhapja e dezinformatave në zgjedhje.

Takim me Rrjetin Gjyqësor Zgjedhor nën rajonal

Në nëntor 2022, Kryesuesi i PZAP-it dhe Kryesuesi i Sekretariatit, kanë marrë pjesë në takimin e Rrjetit Gjyqësor Zgjedhor nën rajonal që është organizuar nga Zyra Rajonale e IFES-it në Evropë, dhe i cili është mbajtur në Tiranë të Republikës së Shqipërisë.

Në këtë takim të organizuar nga përfaqësuesit e Zyrës Rajonale të IFES-it, në Evropë, në bashkëpunim me përfaqësuesit e Komisionit Shtetërorë të Zgjedhjeve (KSHZ) dhe Kolegjit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, kanë marrë pjesë ekspert dhe zyrtar përgjegjës të institucioneve që merren me organizimin e zgjedhjeve dhe të drejtësisë zgjedhore nga rajoni i Ballkanit Perëndimor, përfshirë Shqipërinë, Kroacinë, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Serbia, në të cilin takim janë diskutuar çështjet urgjente lidhur me transparencën, verifikimin, auditueshmerinë dhe mbrojtjen e të dhënave në lidhje me përdorimin e Teknologjisë Informative në Zgjedhje, si dhe përdorimin e mjeteve dixhitale për të forcuar qasjen në drejtësi, efikasitet dhe transparencë.

Siç u theksua më lartë kryesuesi i PZAP-it dhe Kryesuesi i sekretariatit nën organizim të IFES, kanë marr pjesë në forumin rajonal të institucioneve që merren me organizimin e zgjedhjeve dhe drejtësisë zgjedhore të mbajtura në Shkup të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në takimin e Rrjetit Gjyqësor Zgjedhor nën rajonal që është organizuar në Tiranë të Republikës së Shqipërisë

Takimet me anëtarët e Komisionit Ad hoc, për reformën zgjedhore

Në kuadër të plotësim ndryshimit të legjislacionit për reformën zgjedhore në Republikën e Kosovës, janë mbajtur disa takime me pjesëmarrje të përfaqësuesve nga PZAP-i, dhe përfaqësuesve të KQZ-së, Komisionit Ad-Hoc të Kuvendit të Kosovës për Reformë Zgjedhore në Kosovë, Shef i Zyrës së BE-së, ku janë prezantuar rekomandimet e BE-së, nga çështjet si: administrimi i zgjedhjeve dhe kontestet zgjedhore, regjistrimi i votuesve, regjistrimi i kandidatëve dhe entiteteve politike, fushata zgjedhore dhe financimi, votimi, numërimi i votave dhe tabelimi i rezultateve, pjesëmarrja e grave dhe personave me aftësi të kufizuara, media.

Me qëllim të përmbushjes aktiviteteve të parapara me Planin Vjetor të punës për vitin 2022, PZAP-i, ka organizuar dy punëtori të cilat janë mbajtur në Durrës të Republikës së Shqipërisë. Punëtorja e parë është mbajtur në muajin mars 2022, ndërsa punëtorja e dytë është mbajtur në muajin shtator 2022. Në këto punëtori kanë marrë pjesë anëtarët e PZAP-it, personeli i sekretariatit të PZAP-it, si dhe përfaqësuesit nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, ku janë prezantuar dhe shqyrtuar materialet më qëllim të finalizimit të tyre, si në vijim:

- Plani i Punës të PZAP-it, për vitin 2022,
- Raporti Vjetor i punës së PZAP-it, për vitin 2021,

- Materiali lidhur me sfidat e procesit zgjedhor për Zgjedhjet e Parakohshme Për Kuvendin e Kosovës 2021 si dhe ato të Zgjedhjeve Lokale 2021,
- Draft Rregulloren për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave dhe Apeleve.

Lidhur me draftimin e Rregullores për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, grupi punues në përbërje nga anëtarët e PZAP-it dhe Sekretariatit për finalizimin e saj kanë organizuar dhe ka mbajtur dy takime në zyrat e PZAP-it, në qershor dhe korrik të vitit 2022. Këto dy takime janë organizuar dhe mbajtur në bashkëpunim me përfaqësuesit e OSBE-së.

Aktivitetet e Sekretariatit

Gjatë vitit 2022, Sekretariati i PZAP-it, ka mbajtur takime të rregullta, të cilat/ve takime i kanë parapri mbajtjes së takimeve të rregullta të Panelit. Zyrtarët e Sekretariatit kanë përgatitur të gjitha materialet e nevojshme për mbajtjen e takimeve të PZAP-it, si draft agjendat e takimeve, procesverbalet e takimeve/mbledhjeve të kaluara të PZAP-it, përgatitjen e vendimeve për aprovim në takimet e mbajtur nga PZAP-i.

Në kuadër të hartimit të dokumenteve ligjore dhe strategjike, gjatë kësaj periudhe raportuese, zyrtarët e Sekretariatit, gjegjësisht zyrtarët nga Departamenti Ligjor kanë përgatitur draft Rregulloren për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave dhe Apeleve, e cila është aprovuar nga PZAP, dhe nënshkruar nga Kryesuesi në nëntor të vitit 2022. Nxjerrja e kësaj rregulloreje ka ardhur si nevojë e realizimit sa më të lehtë të mandatit ligjor që PZAP, ka në përgatitjen dhe nxjerrjen vendimeve lidhur me ankesat dhe apelet që parashtrohen në PZAP nga palët që kanë interes ligjore, me pretendimin se gjatë një procesi zgjedhor të drejtat e tyre janë shkelur nga palët tjera. Njëherit unifikimi i një rregullore të vetme nga katër sa ishin deri me tani, të cilat bënin rregullime për rregullat dhe procedurat e PZAP-it, Rregullore për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave, Rregulloren për Sistemin dhe Menaxhimin e Brendshëm të Lëndëve, dhe Rregullores për Procedurat e Hetimit të Materialit Zgjedhor, ka bërë se gjatë zbatimit të saj në praktikë, të jetë një dokument shumë lehtësues, si për palët e interesuara të jashtme, për institucionet ndërlidhëse dhe për vetë stafin e Sekretariatit të PZAP-it.

Gjithashtu brenda vitit 2022 është punuar dhe finalizuar vëllimi i tretë i Buletinit të PZAP-it, në të cilin janë paraqitur pesëdhjetë vendime më të rëndësishme që PZAP-i, ka nxjerr për tri palë zgjedhje të organizuara në Kosovë në vitin 2019 dhe në vitin 2021 që kanë të bëjnë me ankesat / apelet e palëve të interesuar nga pretendimet e tyre se janë shkelur të drejtat gjatë procesit zgjedhor, në fazën e para fushatës zgjedhore, fushatën zgjedhore,

thyerjen e heshtjes zgjedhore, ditën e zgjedhjeve, administrimin e rezultateve në qendrën e numërimit dhe rezultateve (QNR).

Në kuadër të këtij buletini janë përzgjedhur vendimet për proceset zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura në vitin 2019 dhe 2021, si dhe Zgjedhjeve Lokale të mbajtura në vitin 2021, (për këto tri palë zgjedhje numri i ankesave/apelveve të parashtruara në PZAP dhe për të cilat PZAP-i, ka marrë vendime është:) janë parashtruar, 666 ankesa dhe 1765 apele, gjithsej 2431 ankesë/apelle të parashtruara në PZAP.

Janë bërë përgatitjet për identifikimin e objektivave dhe aktiviteteve të Planit Strategjik të PZAP-it, për periudhën 2023-2026.

Pastaj janë shqyrtuar dhe diskutuar të gjitha çështjet administrative që janë në përgjegjësi të sekretariatit siç janë ato lidhur me personelin e sekretariatit, çështjet e prokurimit, çështjet e buxhetit dhe financave, çështjet e teknologjisë informative dhe logjistikës, të përkthimit të dokumenteve të PZAP-it, çështje të transportit etj.

Në përputhje me mandatin e përcaktuar me ligjet e aplikueshme, zyrtari përgjegjës i Sekretariatit të PZAP-it, ka marrë vendime për të gjitha çështjet administrative që ndërlidhën me funksionimin e PZAP-it: Në kuadër të aktiviteteve të kryera dhe dokumenteve të përgatitura nga zyrtaret e Departamentit Ligjor, në nivel të përgjegjësisë janë nxjerr vendime nga sekretariati, ndërsa të tjerat janë dërguar për miratim në Panelin e PZAP-it.

- Përgatitja e Draft Planit Vjetor të punës së PZAP-it për vitin 2022, propozim vendimi për miratimin e tij,
- Propozim vendimet për mbajtjen e punëtorive në Durrësit me 24 dhe 27 mars 2022 si dhe me 29 shtator dhe 02 tetor 2022,
- Përgatitja e Draft Raportit të punës së PZAP-it, për vitin 2021,
- Përgatitja e Draft Planit të veprimit për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të komunave së Mitrovicës së Veriut, Zveçan, Leposaviq, Zubin Potok si dhe draft Planit të veprimit për zgjedhjet e parakohshme për kuvendet e komunave, Zveçan dhe Leposaviq,
- Propozim vendimet për zgjatjen e orarit të punës për zyrtarët e Sekretariatit për zgjedhjet jashtëzakonshme për kryetar të komunave të Mitrovicës së Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok dhe atyre për zgjedhjet e parakohshme për kuvendet e komunave, Zveçan dhe Leposaviq,
- Propozim vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e (unifikimin) e rregullave dhe procedurave të PZAP-it,

- Propozim vendimet lidhur me organizimet për mbajtjen e takimeve rreth përfundimit të mandatit me ish anëtarët e PZAP-it, dhe takimit të fund vitit me anëtarët e PZAP-it, dhe Sekretariatit,
- Vendimi për vazhdimin e emërimit në pozitën e Zëvendësuesit të Drejtorit të Departamentit Ligjor të SPZAP-it, për shkak të mbetjes së kësaj pozite vakante,
- Vendimi për vazhdimin e emërimit në pozitën e Zëvendësuesit të Zyrtarit të Lartë Ligjor,
- Vendimin për caktimin e detyrave shtesë për zyrtarët e Sekretariatit të SPZAP-it, për qasje në SIMFK,
- Vendimin për ndryshimin e kategorisë së pagës shtesë në kategorinë e veçantë të profesioneve deficitare,
- Vendimi për emërimin e Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave,
- Vendimi për emërimin e Komisionit Disiplinor,
- Vendimi mbi formimin e Komisionit për Pranimin e Mallit, Furnizim me Pajisje të teknologjisë Informative- Llapot sipas Kontratës së PZAP-it Nr.24700-22-001-136,
- Vendimi për pagesën e mëditjes për udhëtim zyrtar në Shkup - Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Tiranë Republika e Shqipërisë, për zyrtarin e transportit në sekretariatit të PZAP-it,
- Vendim për caktimin e detyrave shtesë për zyrtarët e sekretariatit të SPZAP-it, për qasje në SIMFK,
- Vendim për Formimin e Komisionit të Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë (KVLBK),
- Vendim për emërimin e drejtorit të departamentit ligjor në Sekretariatit të PZAP-it,
- Vendim për mbajtjen e takimit të përbashkët në mes të zyrtareve të Sekretariatit të PZAP-it dhe zyrtareve të shërbimit juridik të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- Vendimi mbi formimin e Komisionit për Pranimin e Mallit, Furnizim me Server dhe Pajisje të teknologjisë Informative- sipas Kontratës së PZAP-it Nr.24700-22-002-121,
- Vendimi për formimin e komisionit për vlerësimin e pasurisë jo financiare,
- Vendimi për formimin e komisionit për tjetërsimin e pasurisë jo financiare,
- Vendimi për formimin e komisionit për inventarizimin e pasurisë jo financiare,
- Njoftimi i Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) lidhur me rastet e ankesave dhe apeleve për të cilat ka vendosur PZAP-i, në Zgjedhjet Lokale të vitit 2021, që kanë të bëjnë me elemente të veprës penale. PZAP-i, me këtë njoftim ka udhëzuar KQZ-në, që materialet e këtyre Qendrave të Votimit (QV) dhe Vendvotimeve (VV) të mos shkatërrohen pasi që janë objekt hetimi nga Prokuroria e Shtetit.
- Njoftimi i Prokurorisë së Shtetit, me rastet e ankesave dhe apeleve për të cilat ka vendosur PZAP-i, në Zgjedhjet Lokale të vitit 2021, që kanë të bëjnë me elemente të veprës penale.
- Përgatitja dhe dorëzimi i Kërkesave Buxhetore në Ministrinë e Financave për vitet 2023-2025,

- Dorëzimi i Pasqyrave Financiare të PZAP-it, për vitin 2021 në Ministrinë e Financave, etj.
- Përgatitja dhe dorëzimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH-it) në Ministrinë e Financave për vitet 2023-2025.

Përgatitjet për zgjedhjet e jashtëzakonshme

Pas marrjes së vendimit Nr. 76 të datës 14 Nëntor 2022 dhe vendimit Nr. 77 të datës 25 Nëntor 2022, nga ana e Presidentes së Republikës së Kosovës për caktimin e datës së zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar të komunave në komunat Mitrovica e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan të parapara që të mbahen me 18.12.2022 si dhe për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendet e Komunave Leposaviq dhe Zveçan, të parapara që të mbahen me 25.12.2022, PZAP-i, ka përgatitur dhe ka miratuar planin e veprimit për këto dy procese zgjedhor, si dhe ka marrë vendim për zgjatje e orarit të punës dhe të organizoj kujdestari.

PZAP-i, gjatë kësaj periudhe kohore të këtij procesi zgjedhor, ka njoftuar KQZ-në lidhur me emrat e personave të cilëve me vendimet e PZAP-it, ju është ndaluar pjesëmarrja në zgjedhje si kandidat apo si staf administrativ, si dhe e ka njoftuar lidhur me gjobat e papaguara të subjekteve politike.

Bashkëpunimi me akteret e tjerë të zgjedhjeve

Në bazë të Memorandumit të Bashkëpunimit të nënshkruar në vitin 2016, në mes të akterëve të zgjedhjeve, PZAP-it, KQZ-së, Prokurorisë së Shtetit, Policisë së Kosovës dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës, PZAP, ka implementuar të gjitha obligimet e parapara me këtë Memorandum. Niveli i bashkëpunimit me akterët e këtij memorandumi është ngritur në veçanti pas shpalljes së Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Mitrovicë të Veriut, Zubin Potok, Zveçan, dhe Leposaviq të caktuara më datën 18.12.2022, si dhe Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend Komunal në Zveçan dhe Leposaviq të caktuara më datë 25.12.2022.

Me qëllim të koordinimit të aktiviteteve në mes të akterëve të zgjedhjeve nënshkruese të Memorandumit është mbajtur takimi i organizuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me koordinimin e aktiviteteve të gjitha institucioneve për zgjedhjet e shpallura, Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Mitrovicë të Veriut, Zubin Potok, Zveçan, dhe Leposaviq, të caktuara më datën 18.12.2022 si dhe Zgjedhjet e

Parakohshme për Kuvend Komunal në Zveçan dhe Leposaviq të caktuara më datë 25.12.2022.

Temat e takimit kryesisht kanë qenë lidhur me Sigurinë për zgjedhjet në Komunitet e Veriut të caktuara në Dhjetor të vitit 2022.

Përveç këtij takimi dhe aktiviteteve në mes të PZAP-it, dhe KQZ-së, ka pasur shkëmbim të informatare lidhur me gjobat e papaguara të subjekteve politike, pastaj me emrat e personave të ndaluar me vendime të PZAP-it, për mos pjesëmarrje në zgjedhje të organizuara nga KQZ-ja, njoftimin me vendvotimet e Zgjedhjeve Lokale të mbajtura me 17 Tetor 2022, materialet e të cilave janë objekt hetimi penal si dhe për shumë aktivitete të tjera.

Në pajtim me nenin 38 paragrafi 3 të Ligjit Nr.03-L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe nenin 3.11 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it “rastet e përgjegjësi individuale gjatë procesit zgjedhor që janë të ndëshkueshme me Kodin Penal të Republikës së Kosovës”, lidhur me Zgjedhjet Lokale të mbajtura me datën 17 Tetor 2021, PZAP-i, ka dërguar në Prokurorinë e Shtetit të Republikës së Kosovës, listën me evidencën e lëndëve të cilat kanë tentuar të ndikojnë në rezultatet e zgjedhjeve e që paraqesin vepër penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe ngritja e kapaciteteve

Nga njësia e personelit gjatë këtij viti, janë kryer aktivitetet e parapara që i përkasin kësaj njësie, respektivisht aktivitetet në fushën e burimeve njerëzore siç ishin në planin e punës së PZAP për vitin 2022.

- Përditësimi i të dhënave të nëpunësve civil dhe anëtarëve të PZAP-it, në dosjet e tyre personale në mënyrë fizike dhe elektronike përmes Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (SIMBNJ),
- Përgatitja e raportit vjetor për menaxhimin e burimeve njerëzore deri me 31 Dhjetor 2021 përmes SIMBNJ-së,
- Planifikimi i pushimit vjetor sipas planit orientues të pushimeve për vitin 2022, në SIMBNJ,
- Përgatitja e listës së zyrtarëve të lartë publik të PZAP-it, sipas kërkesës nga Agjensioni Kundër Korrupsionit, njoftim i zyrtarëve të lartë publik lidhur me deklarin e rregullt vjetor të pasurisë, njoftimi i Agjencisë Kundër Korrupsionit për pranimin e dhuratave për vitin 2021, dhe deklarimi i rregullt vjetor i pasurisë nga zyrtarët e lartë publik,
- Shkarkimi i listës së pagave të zyrtarëve të PZAP-it, nga sistemi i listës së pagave të Ministrisë së Financave,
- Përgatitja e kërkesave për pushimet vjetore për personelin e SPZAP-it, në mënyrë fizike dhe përmes SIMBNJ,

- Menaxhimi i sistemit të vijueshmërisë në punë SMVP, të zyrtarëve të sekretariatit në mënyre elektronike dhe fizike,
- Përgatitja e vendimeve të ndryshme, për emërimin e zëvendësuesve të pozitave si Drejtor i Departamentit Ligjor dhe Zyrtar i Lartë Ligjor,
- Menaxhimi i formularëve të vlerësimit të performances së zyrtareve për vitin 2021, në SIMBNJ,
- Bashkëpunimi me IKAP, për pjesëmarrjen e personelit të sekretariatit të PZAP-it, sipas ftesave dhe planit kalendarik të IKAP-it,
- Bashkëpunimi me auditorët e Zyrës Kombëtare të Auditimit, ofrimi i dokumentacionit të kërkuar sa i përket fushës së burimeve njerëzore,
- Bashkëpunimi me auditorët e Brendshëm nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ofrimi i dokumentacionit sa i përket fushës së burimeve njerëzore,
- Bashkëpunimi me ASHI, lidhur me sistemin SMVP,
- Bashkëpunimi me Departamentin e Thesarit, lidhur me vazhdimin e qasjes në sistemin e pagave,
- Bashkëpunimi me sektorin e listës së pagave, lidhur me formularët e listës së pagave dhe dokumente tjera për anëtarët e larguar dhe anëtarët e emëruar të PZAP-it,
- Pjesëmarrje në trajnimin për Zyrtar të të hyrave i organizuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve,
- Zhvillimi i procedurës së rekrutimit sipas lëvizjes brenda kategorisë për pozitën Drejtor i Departamentit Ligjor, dhe plotësimi i kësaj pozite,
- Bashkëpunimi me MPB lidhur me çështjet e personelit,
- Procesi i klasifikimit të vendeve të punës për personelin e SPZAP-it, sipas kërkesës nga DMZP/MPB, dhe dërgimi në DMZP.

Trajnimet e zyrtareve të sekretariatit

Personeli i Sekretariatit të PZAP-it, gjatë vitit 2022, ka marrë pjesë në trajnimet e organizuara nga MPB/DMZP, projekte të Bashkimit Evropian si:

- Rekrutimi dhe Zhvillimi i Karrierës (RZHK),
- Procesi i Klasifikimit të Vendeve të Punës për Zyrtarët Publik,
- Vlerësimi i përfomancës për nëpunësit civil,

Trajnimet e organizuara nga IKAP dhe të mbajtura nga zyrtaret e Sekretariatit janë:

- Menaxhimi e kontratës përmes e-prokurimit,
- Menaxhimi i stresit,
- Sistemi për mbrojtjen e të dhënave personale,
- Qasje në dokumente publike,

- Auditimi i burimeve njerëzore,
- Menaxhimi i kohës dhe delegimi i përgjegjësi
- Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Kërkesave,
- Adresimi i diskriminimit në vendin e punës
- Për pranimin e mallit, të organizuar nga Departamenti i Thesarit,
- Disiplina dhe ankimimi në shërbimin civil,
- Te drejtat dhe detyrat e zyrtarit publik dhe kodi i mirësjelljes,
- Zbatimi në praktike e ligjit për qasje në dokumente publike,
- Menaxhimi i burimeve njerëzore,
- Klasifikimi i pozitave të punës në shërbimin civil,
- Pranimi dhe karriera në Shërbimin Civil,
- Baza Ligjore e shërbimit civil, planet e personelit dhe SIMBNJ.

Aktivitetet nga fusha e prokurimit

Njësia e prokurimit të PZAP-it, në bazë të Planit Final të Prokurimit Publik për vitin fiskal 2022, ka paraparë disa aktivitete të prokurimit, të cilat gjatë vitit 2022, ka kryer si në vijim:

- Përgatitja e Planit Paraprak të Prokurimit Publik për vitin 2022,
- Publikimi në mënyrë elektronike përmes E-Prokurimit, Plani Final i Prokurimit Publik për vitin 2022,
- Përgatitja dhe dorëzimi i Raportit për Kontratat e nënshkruara nga PZAP-i, dhe kontratat valide të nënshkruara nga AQP-ja, në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik-KRPP,
- Zhvillimi i aktivitetit të prokurimit për Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative-llaptop, për stafin e SPZAP-it,
- Zhvillimi i aktivitetit të prokurimit për Furnizim me server dhe pajisje të tjera të Teknologjisë Informative për PZAP-in,
- Zhvillimi i aktivitetit të prokurimit për Sigurimin e 2 automjeteve të PZAP-it,
- Kryerja e urdhër blerjeve, për të gjitha kontratat e plotfuqishme me Operatorët Ekonomik (kontratat e lidhura nga AQP dhe PZAP).

Aktivitetet lidhur me shpenzimet financiare të certifikuara

Gjatë vitit 2022, është bërë certifikimi i të gjitha shpenzimeve të realizuara financiare për nevojat e PZAP-it, si:

- Aprovimi i shpenzimeve të realizuara për të gjitha kontratat e lidhura me operatorët ekonomik si: (shpenzimet e telefonisë fikse, telefonisë mobile, për ujë të pijshëm, pastrimin

e veturave të PZAP-it, TV kabllor dhe internet, shpenzimet për shfrytëzimin e fotokopjeve dhe printerëve me qira) etj,

- Aprovimi i shpenzimeve lidhur me pagesat për përmbarimin e vendimeve me titull ekzekutiv,
- Aprovimi i shpenzimeve lidhur për punëtoritë e mbajtura të PZAP-it,
- Aprovimi i shpenzimeve lidhur me pagesat për karburante të veturave të PZAP-it,
- Aprovimi i shpenzimeve lidhur me pagesat për Furnizimi me server dhe pajisje tjera të TI,
- Aprovimi i shpenzimeve lidhur me pagesat për blerjen e llaptopeve të PZAP-it,
- Aprovimi i shpenzimeve lidhur pagesat e shpenzimeve për printimin dhe rregullimin e Raportit vjetor të punës, Planin e punës dhe Rregullores se PZAP-it,
- Aprovimi i shpenzimeve lidhur me pagesat për takimet e fund vitit të mbajtura të PZAP-it,
- Aprovimi i shpenzimeve lidhur me udhëtimet zyrtare të zyrtarëve të sekretariatit dhe anëtarëve të PZAP-it,
- Aprovimi i shpenzimeve për blerjen dhe furnizimin me material administrativ për PZAP,
- Aprovimi, mbyllja e avanseve dhe petty-cashit për shpenzimet e realizuara,
- Aprovimi i shpenzimeve të tjera të nevojshme për PZAP-in.

Aktivitetet nga fusha e komunikimit dhe informimit

Përveç kërkesës të protokolluar për Qasje në Dokumente Publike, gjatë vitit 2022, Sekretariati ka pranuar dy kërkesa përmes emailave nga gazetari i televizionit KTV dhe organizata jo qeveritare, të cilët kanë kërkuar informata të ndryshme lidhur me proceset zgjedhore 2021, dhe të gjitha këtyre informatave të kërkuara nga palët, brenda afatit iu është dhënë përgjigje nëpërmjet emailit.

Ne shkurt 2022 nëpërmjet e-mailit ka pranuar pyetjet nga gazetari i televizionit KTV lidhur me shkeljet e Kodit të Mirësjelljes së partive politike nga zgjedhjet e fundit.

PZAP-i më datë 17 Mars 2022 nëpërmjet e-mailit ka pranuar kërkesën nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) si degë e Transparency International, me përkrahje të Komisionit Evropian për Intervistë Hulumtuese në kuadër të Vlerësimit të Sistemit Kombëtar të INTEGRITETIT (NIS) në Kosovë. Ky vlerësim bëhet individualisht për shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë, dhe përfshinë 15 institucionet kryesore të vendeve, të cilat poentohen mbi bazën e disa indikatorëve. NIS shërben si pikë reference për BE-në lidhur me vlerësimin e progresit të institucioneve të caktuara. Pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës më datë 22 Mars 2022, PZAP-i nëpërmjet e-mailit, Institutit Demokratik të Kosovës i ka dorëzuar pyetësorin bashkë me përgjigjet në formë elektronike.

Kërkesat për Qasje në dokumente publike

PZAP-i, në Janar 2022, ka përgatitur dhe dorëzuar Raportin për Qasje në Dokumente Publike për vitin 2021, sipas kërkesës së Agjencisë për Informim dhe Privatësi.

PZAP-i, gjatë vitit 2022, ka pranuar dhe protokolluar një kërkesë që ka të bëjë me Qasjen në dokumente publike dhe dy kërkesa nëpërmjet emailit.

Kërkesa me numër protokolli Nr.21-2022, është pranuar me datën 10 Mars 2022, nga Drejtoria Rajonale e Policisë Gjakovë- Stacioni Policor në Malishevë-Njësitit të Hetimeve e cila emailit ka kërkuar nga PZAP-i, materialin e Vendvotimit 3016/01R dhe rinumërimin e votave për kandidatin A.M dhe M.M. Pas shqyrtimit të kërkesës nga kryesuesi i SPZAP-it, iu është kthyer përgjigja në kopje fizike dhe nëpërmjet emailit më datë 15 Mars 2022, duke ia bashkangjitur materialin që ka të bëjë me Apelin Anr.1068/2021 i datës 04 Nëntor 2021 të parashtruesit A.M.

Buxheti dhe financat

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa është organizatë buxhetore, me kod organizativ 247 dhe me kod funksional 0160. PZAP-i, financohet nga Buxheti i Përgjithshëm i Kosovës.

Raporti vjetor i shpenzimeve për vitin fiskal 2022, përmban të gjitha shpenzimet e krijuara gjatë këtij viti. Ky raport është përgatitur në pajtim me LMFPP (03/L-48) dhe SNKSP dhe sipas parimit të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme. Politikat kontabël janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme gjatë tërë periudhës së realizimit të shpenzimeve. Bazë për hartimin e dokumentit kanë shërbyer raportet e SIMFK, të dhënat nga sektori i financave si librat, faturat, raportet e pranimit të mallit, kontratat dhe dokumentet tjera të PZAP-it.

Të gjitha pagesat janë bërë përmes sistemit të Menaxhimit të Financave Publike të Kosovës (SIMFK- Free Balanc) në sistemin kesh-it (parave të gatshme) e jo të zotimit.

Valuta raportuese është euro (€)

Aprovimi i buxhetit

Me Ligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës Nr. 08/L-066 për vitin 2022 për Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa, është ndarë buxhet në shumë prej 215,281€.

Planifikimi buxhetit është bërë në nivel të kategorive ekonomike, përkatësisht të zërave duke respektuar legjislacionin financiar, Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik dhe në përputhje me strukturën egzistuese të planit kontabël.

Në kuadër të këtij buxheti, planifikimi është bërë për kategori ekonomike si në vijim:

- Paga dhe shtesa,
- Mallra dhe shërbime,
- Shpenzime komunale dhe
- Pasurit jo financiare (shpenzimet kapitale)


Në mënyrë të detajuar janë të paraqitura në formë tabelore

Buxheti fillestar i aprovuar dhe buxheti i ndryshuar gjatë vitit 2022

Kategoritë Ekonomike	Buxheti fillestar i aprovuar 2022
Paga dhe shtesa	140,221
Mallra dhe shërbime	52,240
Shpenzime Komunale	7,820
Shpenzimet kapitale	15,000
Total:	215,281

Duke analizuar buxhetin e PZAP-it, në shumë prej 215,281€ si dhe strukturën buxhetore rezulton se prej tyre :

- 65 % të fondeve janë akorduar për mbulimin e shpenzimeve për paga dhe shtesa,
- 25 % të fondeve është akorduar për shpenzime mallra dhe shërbime,
- 3.60 % për shpenzimet komunale ,
- 7 % për shpenzimet kapitale.



Realizimi i buxhetit

Pas aprovimit të buxhetit për vitin 2022, në përputhshmëri me planin operacional, është bërë menaxhimi i fondeve të akorduara për Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa. Buxheti është realizuar me korrektësi sipas zërave të shpenzimeve dhe me efektivitet duke treguar kujdes që fondet e miratuara të shpenzohen sipas planit në kohën e duhur dhe me një administrim ekonomik efektiv.

Realizimi i buxhetit, përkatësisht shpenzimet e PZAP-it, për vitin 2022 sipas kategorive ekonomike i shprehur edhe në përqindje duket si në vijim:


Tabela Buxhetit dhe Shpenzimeve -2022

Kategoritë Ekonomike	Buxheti fillestar i aprovuar 2022	Buxheti i shpenzuar-2022	Përqindja (%) e buxhetit të shpenzuar Për vitin 2022
Paga dhe shtesa	140,221	135,332	97%
Mallra dhe shërbime	52,240	31,484	61%
Shërbime Komunale	7,820	126	1%
Shpenzimet kapitale	15,000	14,989	99%
Total:	215,281	181,932	85%


Në kategorinë e pagave dhe shtesave gjatë vitit janë shpenzuar 97% e buxhetit total të pagave, në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve është shpenzuar 61% e buxhetit, në kategorinë e shërbimeve komunale është shpenzua 1% buxhetit dhe për kategorinë e shpenzimeve kapitale është shpenzua 99% e buxhetit për këtë kategori.

Gjithsejtë buxheti i shpenzuar gjatë vitit 2022, është në shumë prej 181,932€ apo 85% e buxhetit të aprovuar të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa.

Paraqitja grafike e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike



Paraqitja grafike e krahasimit të shpenzimeve të vitit 2022 me shpenzimet e vitit 2021



Nga kjo paraqitje grafike e krahasimit të shpenzimit të buxhetit të vitit 2021 me buxhetin e vitit 2022 shihet qartë dhe vërtetohet se në vitin 2021 buxheti është shpenzuar 23.6% më shumë se në vitin 2022, për arsye se viti 2021 ka qenë vit zgjedhor ku janë organizuar dhe mbajtur dy procese zgjedhore, Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës dhe Zgjedhjet Lokale dhe për arsye të rritjes dhe shtimit të aktiviteteve zgjedhore ankimore edhe shpenzimet në vitin 2021 kanë qenë më të larta.


Paga dhe shtesa

Sipas buxhetit të aprovuar për vitin 2022, PZAP ka 20 pozita/zyrtarë të aprovuar prej të cilëve 10 anëtar të PZAP-së dhe 10 shërbyes civil të Sekretariatit të PZAP-së

Te kategoria e pagave dhe shtesave Buxheti i aprovuar ka qenë 140,221€, gjatë vitit 2022 për këtë kategori nuk kemi pasur ndryshime. Nga kjo kategori buxheti është shpenzuar në shumë prej 135,332€, çka do të thotë se është shpenzuar 97% e buxhetit të aprovuar për kategorinë e pagave.

në €

Kategoritë ekonomike	Shpenzimet -2022
Paga dhe shtesa	135,332
Pagat neto përmes listës se pagave për anëtarët e PZAP-it	43,773
Pagat neto përmes listës se pagave për zyrtarët SPZAP-së	68,924
Tatimi i ndalur në të ardhura personale	9,747
Kontributi pensional i punëtorit	6,444
Kontributi pensional i punëdhënësit	6,444



Mallra dhe shërbime

Te kategoria e mallrave dhe shërbimeve Buxheti i aprovuar ka qenë 52,240€. Gjithashtu te kjo kategori gjatë vitit 2022 nuk kemi pasur ndryshime. Nga kjo kategori buxheti është shpenzuar në shumë prej 31,484€ apo 61% e buxhetit të aprovuar

Këto shpenzime janë realizuar nëpërmjet:

- Modulit të aprovimeve dhe
- Modulit të blerjeve-prokurimit.


Me poshtë janë të prezantuara në formë tabelore të detajuara shpenzimet e kategorisë në mallra dhe shërbime për vitin 2022.

Shpenzimet nga mallrat dhe shërbimet sipas nën kodeve ekonomike

në €

Kategoritë ekonomike	Shpenzimet -2022
Mallra dhe Shërbime	31,484
Mëditja e udhëtimit zyrtar jashtë vendit	6,278
Akomodimi- udhëtimet zyrtar jashtë vendit	5,840
Shpenzimet tjera të udhët. zyrtare jashtë vendit	943
Shpenzimet për internet	638
Shërbimet tjera telefonike vala 900	6,940
Shërbimet kontraktuese tjera	1,486
Harduer për TI me pak se 1000 euro	2,741
Furnizimi për Zyre	519
Furnizim me ushqim dhe pije –jo dreka zyrt.-uji	279
Karburante për vetura	1,517
Regjistrimi i automjeteve	150
Sigurimi i automjeteve	997
Taks komunale për regjistrim të automjet. Zyrtar	20
Mirëmbajtja, riparimi i automjeteve	381
Mirëmbajtja e teknologjisë informative	35
Qiraja e pajisjeve te TI	756.51
Drekat zyrtare	1,964

Paraqitja grafike e shpenzimeve në kategorinë mallra dhe shërbime sipas kodeve ekonomike



Shpenzimet komunale

Te kategoria e shpenzimeve komunale Buxheti i aprovuar ka qenë 7,820€. Edhe të kjo kategori gjatë vitit 2022 nuk kemi pasur ndryshime.

Nga kjo kategori buxheti është shpenzuar në shumë prej 127€.


Shpenzimet kapitale

Tek kategoria e shpenzimeve kapitale buxheti i aprovuar ka qenë në shumë prej 15,000€, të kjo kategori ka qenë i planifikuar projekti për blerjen e serverit të ri për nevoja të PZAP-it, të cilin projekt e kemi realizuar gjatë vitit 2022, shuma e buxhetit të shpenzuar për këtë projekt është 14,989€ apo 99% e buxhetit të aprovuar.

Pjesa përmbyllëse e Shpenzimeve

Në bazë të dhënave të SIMFK dhe data bazës të Sekretariatit të PZAP-it, mund të përfundojmë se për vitin 2022 buxheti është shpenzuar në shumë prej **181,932€**. Pjesë përmbyllëse e këtij raporti të shpenzimeve është paraqitja grafike e planifikimit dhe realizimit të Buxhetit për vitin 2022.

Paraqitja grafike e buxhetit të planifikuar dhe shpenzuara



Te hyrat e PZAP-it

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP-i) në bazë të nenit 120 paragrafi 1 pika c. të Ligjit Nr. 03/L-256 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 mund të shqiptoj gjoba ndaj një subjekti politik në vlerë deri në pesëdhjetëmijë (50,000) Euro, në rast se përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ligji ose rregullave të KQZ-së.

PZAP-i gjatë vitit 2022, nuk ka shqiptuar asnjë gjobë ndaj subjekteve politike për shkak se nuk ka pas zgjedhje. Mirëpo ka realizuar (inkasuar) të hyra në vlerë prej 39,400€ prej gjobave të shqiptuara ndaj subjekteve politike më vendimet e PZAP-it nga zgjedhjet e vitit 2021, ku është bërë pranimi i të gjitha të hyrave në sistemin e Free Bilancit, sipas kërkesave të Departamentit të Thesarit që ka pasur të hyra në llogarinë e PZAP-it.

Nga zgjedhjet e kaluara borxhe të pa realizuara kanë mbetur edhe 6,100€ ku prej tyre 4,000€ janë gjoba të papaguar nga Koalicioni Sloboda të mbetura prej zgjedhjeve të vitit 2019. PZAP-i në përputhje me ligjet e aplikueshme të Kosovës me Koalicioni Sloboda ka nënshkruar një Marrëveshje Mirëkuptimi për pagesën e këtyre borxheve me këste. Shuma tjetër e gjobave të pa paguara ka mbetur nga procesi zgjedhor të Zgjedhjeve Lokale që janë mbajtur në vitin 2021, 1,800€ dhe 300€ nga subjekti politik Lista e pa varur Bekim Jashari dhe nga subjekti politik Organizata Balli Kombëtar Demokrat-OB.

Borxhet e papaguara do ti inkasojmë në përputhje me Ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Mbetja e gjobave të pa paguara të Subjekteve politike

Nr.	Emri i subjektit politik	Shuma e gjobës
1	Lista e Pavarur-Bekim Jashari	1,800.00
2	Organizata Balli Kombëtar Demokrat-OBKD	300.00
3	Koalicioni Slloboda	4,000
	TOTAL	6,100

Te hyrat e realizuara gjatë vitit 2022

Nr.	Nr. I vendimit të PZAP	Subjekti politik	Pershkrimi i te hyrave	Pagesa e gjobës	Data e pageses se borxhit
1	Anr.604,618,654,1130,1131,1132/2021	LDK	Pagesa e gjobes në bazë të vendimit Anr. 604,618,654,1130,1131,1132/2021 per Zgjedhjet Lokale -17 tetor-2021	11,500.00	04.02.2022
2	Anr.629,1105,1121,1118,1124,1125,1127,1135,1138/2021	LVV	Pagesa e gjobes në bazë të vendimit Anr. 629,1105,1121,1118,1124,1125,1127,1135,1138/2021 per Zgjedhjet Lokale -17 tetor-2021	11,800.00	04.02.2022
3	Anr.615,617,659,693,1141/2021	PDK	Pagesa e gjobes në bazë të vendimit Anr. 615,617,659,693,1141/2021 per Zgjedhjet Lokale -17 tetor-2021	15,800.00	04.02.2022
4	Anr.1128/2021	AAK	Pagesa e gjobes në bazë të vendimit Anr. 1128-2021 per Zgjedhjet Lokale -17 tetor-2021	300.00	04.02.2022
		Total:		39,400.00	

Gjatë vitit 2022 në llogarinë e të hyrave të PZAP-it, ka pasur realizim të hyrave në shumë prej 39,400 €, ku ky fond i mbledhur transferohet dhe mbahet në Buxhetin e Kosovës.

Auditimi i pasqyrave financiare të PZAP për vitin 2021

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), për çdo vit kryen auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa. ZKA në Raportin e auditimit të PZAP-it për vitin financiar 2021 të datë 17.06.2022 nuk ka dhënë asnjë rekomandim, dhe në opinionin e saj në këtë raport, ka konstatuar se, Pasqyrat Vjetore Financiare të PZAP-it për vitin 2021 prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Sipas konkluzionit të ZKA-së, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të PZAP-së, kanë qenë në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar – PZAP-in në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

ZKA është në fazën përfundimtare të auditimit të Pasqyrave Financiare Vjetore të PZAP-it për vitin 2022, por ende nuk e ka nxjerr/finalizuar Raportin e auditimit të PZAP-it, për vitin financiar 2022. Gjetjet e Raportit final të auditimit të PZAP-it për vitin financiar 2022, do ti paraqesim vitin e ardhshëm në Raportin Vjetor të Punës së PZAP-it për vitin 2023.

Njësia e Teknologjisë së Informacionit dhe Logjistikes

Gjatë periudhës janar-dhjetor - 2022 nga njësia e TI dhe Logjistikes ka kryer disa aktivitete:

Njësia e Teknologjisë Informative ka bërë planifikimin, administrimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e TI-së dhe aplikacioneve të Microsoft të ofruar nga Ministria e Administratës Publike , si dhe mirëmbajtjen dhe administrimin e Ueb faqes dhe Sistemit për Menaxhimin e Rasteve, domeni-it (rrjetin e brendshëm).

Në funksion të përmbushjes së detyrave që ndërlidhen me menaxhimin dhe mirëmbajtjen e çështjeve nga teknologjia informative, janë zhvilluar edhe aktivitete të ndryshme sipas kërkesave të zyrtarëve. Në kuadër të aktiviteteve më kryesore nga kjo njësi, është mirëmbajtja dhe azhurnimi në vazhdimësi i Ueb faqes së PZAP-it, dhe rrjeteve sociale, ku gjatë kësaj periudhe vjetore janë publikuar vendime, formularë, udhëzime , raporti vjetor i punës dhe informacione tjera qe kanë qenë të dobishme për Institucionin. Në vazhdimësi është bërë ofrimi i përkrahjes teknike në Sistemin për Menaxhimin e Rasteve dhe Teknologjisë Informative. Aktivitete tjera nga kjo njësi ka pasur edhe nga fusha të tjera si logjistike ku është bërë regjistrimi i inventarit në sistemin E-Pasuria dhe SIMFK, janë përgatitur specifikat për furnizime sipas kërkesave të njësive përkatëse, furnizim me inventar për zyre, pajisje të teknologjisë informative, sigurimin e automjeteve zyrtare, tërheqja e parave për udhëtime zyrtare jashtë vendit, zotimi i mjeteve

financiare për çdo shpenzim të ndodhur si dhe punë tjera sipas kërkesave të menaxhmentit dhe zyrtarëve të PZAP-së.

Identifikimi i nevojave të PZAP-it, për softuer të licencuar për vitin 2022. Aktivitete tjera nga kjo njësi ka pasur me inventarizimin dhe vlerësimin e aseteve të PZAP-it, përmes programit E-pasuria, ku në këtë lëmi kemi pasur aktivitete të vlerësimit dhe ri-vlerësimit të pajisjeve nga teknologjia informative. Duke u bazuar në Rregulloren MF – NR. 02/2013 – për menaxhimin e pasurisë jo financiare, është bërë rivlerësimi i pasurisë së zhvlerësuar dhe atyre jo funksionale.

Njësia e Përkthimeve

Zyra e përkthimeve, ka kryer të gjitha obligimet e dala nga PZAP/SPZAP, në pajtim me ligjin për përdorimin e gjuhëve zyrtare në Kosovë.

Nga njësia e përkthimeve janë përkthyer të gjitha dokumentet e nevojshme sipas kërkesave të Panelit dhe zyrtarëve të Sekretariatit të PZAP-it si: përkthimi i Raportit Vjetor të punës-2021; Planit të Punës-2022, përkthimi i agjendave dhe procesverbaleve të takimeve të PZAP-it dhe të Sekretariatit të PZAP-it, gjitha njoftime për publikun të publikuara në web faqen zyrtare të PZAP-it si dhe dokumenteve të tjera sipas kërkesës së zyrtarëve.

Nga njësia e për pranimin e mallit në depo, janë bërë të gjitha pranimet e nevojshme që duhet të kryhen rregullisht në bazë të procesit të realizimit të pagesave. Përpos këtyre aktiviteteve, në vazhdimësi janë kryer edhe aktivitete tjera si: kontrollimi i inventarit në depo ku për çdo fund vit bëhet regjistrimi i të gjithë inventarit dhe i materialit administrativ që janë në depo dhe inventarit që është në posedim, ngarkimi i zyrtarëve me material administrativ, ngarkimi dhe shkarkimi i depot si dhe detyra tjera sipas kërkesave të zyrtarëve..

Njësia e Transportit

Nga njësia e transportit gjatë 2022 janë kryer të gjitha shërbimet dhe aktivitetet që kanë të bëjnë me transport si: mbajtja e evidencave të qarkullimit të veturave zyrtare dhe evidentimi i çdo kilometër të kaluar gjatë qarkullimit të automjeteve. Në vazhdimësi janë raportuar në mënyrë specifike për çdo tre muaj edhe në formë tabelave për shpenzimet e litrave të shpenzuara për derivate si dhe kilometrat e kaluara për veturë zyrtare të PZAP-it dhe Veturat e huazuara nga Institucionet e Republikës së Kosovës – Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK).

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ka në pronësi dy makina zyrtare dhe atë:

Automjetin e Tipit: Mitsubishi Outlander me Targa të Regjistrimit RKS 5Z-101-17 dhe,

Automjetin e Tipit: Ford Focus, me Targa të Regjistrimit 5Z-102-17,

Nr. 1 Tabela e pasqyrimin te shpenzimeve në KM dhe Karburante ne litër për vitin 2022

Auto.	KM Jana. - Mars- 2022	Litra Janar - Mars- 2022	KM Prill - Qershor - 2022	Litra Prill - Qershor- 2022	KM Korrik - Shtat. - 2022	Litra Korrik - Shtat. - 2022	KM Tetor – Dhjet. 2022	Litra Tetor – Dhjet. 2022	KM Jana. - Dhjet. 2022	Litra Jana. - Dhjet. 2022
Ford	1142	103	762	44	1265	67	1332	93	3819	307
Ford									682	46
Gjiths ejt:									4501	353
Mitsu bishi	1425	95	841	113	1179	63	906	98	4351	369
Gjiths ejt:	2567	198	1603	157	2444	130	2338	191	8852	676

Gjatë vitit 2022 për veturën zyrtare të PZAP-it FORD, janë shpenzuar 353 litra karburante dhe 4501 kilometra (KM) të kaluara, prej tyre 3819 KM dhe 307 litra karburante janë shpenzuar për nevoja të PZAP-i ndërsa 682 KM dhe 46 litra karburante janë shpenzuar dhe paguar/kompensuar nga Buxheti i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shkak të huazimit të të njëjtit automjetit për mbajtjen e punëtorisë së KQZ-së jashtë vendit në Shqipëri.

Ndërsa për veturën zyrtare MITCUBISHI, për vitin 2022 janë të shpenzuara 369 litra karburante dhe 4351 KM të kaluara.

Shpenzimet e Automjeteve të Huazuara

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) gjatë vitit 2022 më qëllim të realizimit / përmbushjes së aktiviteteve të saj, ka organizuar dy punëtori jashtë vendit në Shqipëri, një (1) në periudhën e parë të vitit 2022 dhe një (1) në periudhën e tretë të vitit 2022, dhe për shkak se nuk ka pas në dispozicion automjete të mjaftueshme për organizmin dhe përkrahjen logjistike të këtyre dy ngjarjeve ka huazuar automjetet e nevojshme nga KGJK dhe KPK.

Nga KGJK-ja kemi huazuar dy automjete:

1. Automjetin e Tipit: Megane me Targa të Regjistrimit RKS 4Z-242-02 dhe,
2. Automjetin e Tipit: Passat me Targa të Regjistrimit RKS 4Z-302-02.

Nga KPK kemi huazuar një automjet:

Automjetin e Tipit: Peugeot me Targa të Regjistrimit 4Z-210-03,

Nr.2 Tabela e pasqyrimit të shpenzimeve në KM dhe Karburante të automjeteve të huazuara për vitin 2022

Auto.	KM Janar- Mars 2022	Litra Janar- Mars 2022	KM Prill- Qershor 2022	Litra Prill- Qershor 2022	KM Korrik- Shtat. 2022	Litra Korrik- Shtat. 2022	KM Tetor- Dhjet. 2022	Litra Tetor- Dhjet. 2022	KM Jana.- Dhjet. 2022	Litra Jana.- Dhjet. 2022
Megane	675	42							675	42
Passat	689	59			700	65			1389	124
Peugeot					650	60			650	60
Gjithsejt:	1364	101			1350	125			2714	226

Siç shihet nga pasqyrimi shpenzimeve në tabelën Nr. 2, makinat e huazuara nga KGJK dhe KPK kanë shpenzuar gjithsejtë 2174 KM dhe 226 litra karburante dhe të njëjtat shpenzime janë paguar me buxhetin e PZAP-it dhe janë pasqyruar në pasqyrat financiare të PZAP-it për vitin 2022.

Gjithsejtë numri i KM të kaluara dhe litra të karburanteve të shpenzuara nga automjetet e PZAP-it dhe Automjetet e huazuara për vitin 2022 të paraqitura në tabelën Nr. 1 dhe Tabelën Nr. 2 sipas periudhave tre mujore dhe vjetore, janë si në vijim:

Auto.	KM Jana r- Mar s 2022	Litra Jana r- Mar s 2022	KM Prill- Qersh or 2022	Litra Prill- Qershor 20 22	KM Korri k- Shtat . 2022	Litra Korri k- Shtat 2022	KM Tetor – Dhjet 2022	Litra Tetor – Dhjet 2022	KM Jana r- Dhje t 2022	Litra Jana r- Dhje t. 2022
Veturat e PZAP-i	2567	198	1603	157	2444	130	2338	191	8852	676
Veturat e Huazuara	1364	101			1350	125			2714	226
Gjithsejtë:	3931	299	1603	157	3794	255	2338	191	11566	902

Përpos këtyre aktiviteteve nga njësia e transportit janë kryer edhe punë tjera si: përcjellje e vazhdueshme e veturave për servise jo të rregullta, ndreqjen e ndonjë defekti akut , është bërë servisi i rregullt i veturave, pastrimin e veturave sipas nevojës, shërbimet me transport sipas kërkesave të Kryetarit, anëtarëve të Panelit si dhe zyrtarëve të SPZAP-it, shpërndarja e dokumenteve të ndryshme nëpër Institucione si dhe punë të tjera.